

VENDIM
Nr.31, datë 4.7.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vladimir Kristo	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datën 4.5.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.37Akti, që i përket:

KËRKUES: RUSTAN SHUBLEKA

SUBJEKT I INTERESUAR: DEGA E POLICISË ELEKTRIKE, DIBËR, përfaqësuar nga Sabri Lani e Agim Ismaili, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.1006, datë 14.10.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.981, datë 7.9.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për papajtueshmërinë e vendimeve të mësipërme me Kushtetutën:

- Vendimi i gjykatës së apelit është marrë në mungesë, duke shkelur të drejtën për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës. Konkretisht, gjykata e apelit nuk ka bërë njoftimin për pjesëmarrjen në gjykim me shpallje pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe me fletëthirrje, siç parashikon neni 460/3 i Kodit të Procedurës Civile. Në këtë mënyrë, kjo gjykatë nuk i ka krijuar mundësinë kërkuesit të marrë pjesë dhe të mbrohet në gjykim.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, kërkuesin, përfaqësuesit e subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr.568, datë 7.12.2004, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë duke detyruar të paditurin, Dega e Policisë Elektrike Dibër, t'i shpërblejë paditësit Rustan Shubleka (kërkuesi) dëmin në shumën 50 mijë lekë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1006, datë 14.10.2005, ka vendosur ndryshimin e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe rrëzimin e padisë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr.981, datë 7.9.2006, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi.

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve të mësipërme, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me arsyetimin se shkelin të drejtën për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Sipas kërkuesit, shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë, është bërë pa praninë e tij, pasi, në kundërshtim me nenin 460/3 të Kodit të Procedurës Civile, kjo gjykatë nuk ka nxjerrë shpallje për ditën dhe orën e gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër. Për pasojë, kërkuesit i është cenuar e drejta e mbrojtjes.

Gjykata Kushtetuese verifikoi nëse në procesin e zhvilluar nga gjykata e apelit janë respektuar standardet e një gjykimi të drejtë në aspektin kushtetues.

Me këtë rast, Gjykata Kushtetuese riafirmon qëndrimin e saj, se pjesëmarrja e palëve në gjykim, respektimi i parimit të barazisë së armëve, të kontradiktoritetit si dhe respektimi i të drejtës së mbrojtjes, janë elemente të rëndësishme të një procesi të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së

Shqipërisë. Për pasojë, gjykata që gjykon çështjen, duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për pjesëmarrjen e palëve apo të përfaqësuesve të tyre në proces, për t'iu krijuar mundësinë atyre të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me mosmarrëveshjen objekt gjykimi.

Gjykata Kushtetuese, në rastin në shqyrtim, konstaton se njoftimi i kërkuarit për gjykimin në Gjykatën e Apelit Tiranë është i pavlefshëm, sepse është kryer në kundërshtim me rregullat e procedurës civile. Sipas nenit 460/3 të Kodit të Procedurës Civile, njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit të çështjeve bëhet nga gjykata e apelit me shpallje pranë saj dhe në gjykatat përkatëse të shkallës së parë, jo më vonë se 10 ditë përpara shqyrtimit të çështjes. Përveç njoftimit me shpallje, sipas nenit 143 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata mund të përdorë edhe mënyra të tjera njoftimi, siç është dhe njoftimi me anën e telegramit me përgjigje. Në këtë drejtim, nga materialet e dosjes rezulton se si njoftimi me shpallje, ashtu edhe njoftimi me telegram nuk janë bërë në përputhje me kërkesat e ligjit procedural. Konkretisht, njoftimi me shpallje është i mangët sepse është bërë vetëm pranë gjykatës së apelit që po shqyrtonte çështjen, por nuk është nxjerrë kjo shpallje edhe pranë gjykatës përkatëse të shkallës së parë, dhe konkretisht, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Edhe mënyra tjetër e njoftimit e aplikuar nga gjykata e apelit është e parregullt në aspektin procedural, sepse në rastin në shqyrtim është aplikuar telegrami i thjeshtë, e jo telegrami me përgjigje, që kërkon dispozita e sipërcituar e Kodit të Procedurës Civile.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese konkludon se Gjykata e Apelit Tiranë, duke shkelur dispozitat procedurale civile, që kanë të bëjnë me mënyrën e njoftimit të palëve, nuk i ka krijuar mundësi kërkuarit të marrë pjesë në gjykimin në apel dhe për këtë shkak, ky gjykim nuk i përmbush standardet e një gjykimi të drejtë në aspektin kushtetues. Përveç kësaj, duke konstatuar se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është rezultat i një procesi të parregullt ligjor, gjë që duhet ta kishte konstatuar edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, Gjykata Kushtetuese duhet të shfuqizojë edhe vendimin e kundërshtuar të këtij kolegji.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr.1006, datë 14.10.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.981, datë 7.9.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.